

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 387 Rep.

Nr. 67 Kol



MARRËVESHJE PËR SHITJEN E PJESËVE TË KAPITALIT

Sot, më dt 06.06.2006, përpara meje, Iliriana Cella, notere pranë Dhomës së Noterëve Tirane, u paraqitën palët e mëposhtme të cilët më deklaruan se duan të lidhin këtë Marrëveshje për Shitjen e Kuotave (Pjesëve) të Kapitalit (më poshtë quajtur "Marrëveshja"):

1. Andrea Maliqari, i biri i Vangjelit, dtl.01.12.1963, lindur Korce dhe banues ne Tirane, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me pasaportën me nr. Z 0538767.
2. Arian Lako, i biri Jorgjit, dtl 21.01.1964, lindur ne Berat dhe banues ne Tirane, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. QH 045047 .
3. Dhimitraq Dhimitri, i biri Llambros, dtl. 08.07.1955, lindur dhe banues në Tirane, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me pasaporten me nr. Z 0892147.

(më poshtë të quajtur "Shitësi").

Dhe


Njazi Nelo, i biri i Harizit dhe i Minos, dtl. 10.3.1936 , lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me pasaportën me nr.1048703.

(më poshtë i quajtur "Blerësi").

MEQËNËSË

- A. Shitësi zotëron 50% te kuotave (më poshtë quajtur "Kuotat e Shitesit") në kapitalin e shoqërisë "ORION" sh.p.k., e krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, rregjistruar me vendimin nr. 19427, datë 12. 05. 1998 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me seli "Rruga e Kavajës", Tiranë, (me poshtë e quajtur "Shoqëria"), me kapital Lekë 100.000 (njëqindmijë), ndarë në 100 pjesë me nga Lekë 1000 secila, ku përkatësisht Shitësi zotëron 50 pjesë.

Handwritten signatures and dates:
- Signature of Andrea Maliqari, dated 06.06.2006.
- Signature of Arian Lako.
- Signature of Dhimitraq Dhimitri.



B. Blerësi dëshiron të blejë të gjitha pjesët e Shitësit të identifikuar në paragrafin (B) me sipër.

Meqë Blerësi nuk është ortak i Shoqërisë dhe me vendim të asamblesë së ortakëve është lejuar shitja e kuotave nga Shitësi, duke u pranuar blerësi si ortak i ri dhe Statuti i Shoqërisë nuk ndalon transferim të kuotave (pjesëve) të kapitalit të tretët, Kuotat e Shitësit mund të transferohen lirisht nga Shitësi tek Blerësi bazuar dhe nenit 47 të Ligjit nr. 7638 "Për Shoqërite Tregtare".

Duke patur parasysh sa më lart palët bien dakort për sa vijon:

NENI 1

SHITJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

Shitësi është dakort të shesë Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi sipas kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, të gjitha Kuotat e Shitësit kundrejt çmimit Lekë 50.000 (pesëdhjetmijë), më poshtë quajtur "Çmimi i Shitjes".

Neni 2

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

2.1 Blerësi i paguan Shitësit në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, të gjithë Çmimin e Shitjes. Blerësi do të përballojë të gjithë rreziqet dhe shpenzimet e rrjedhura nga kursi i këmbimit të valutës së huaj si rrjedhojë e kërkesës së përcaktuar në këtë Marrëveshje për kryerjen e pagesës në Lekë.

2.2 Blerësi do t'i paguajë Shitësit, pa zbritur asnjë lloj takse apo tatimi apo shumë të ngjashme, Çmimin e Shitjes apo çdo shume tjetër që mund të bëhet e pagueshme për shkak të kësaj Marrëveshje. Nëse Blerësi është i detyruar që, sipas ligjit, të zbresë nga Çmimi i Shitjes apo shuma të tjera që mund të bëhen të pagueshme kundrejt Shitësit për shkak të kësaj Marrëveshje, ndonjë taksë, tatim apo ndonjë shumë tjetër të ngjashme që mund të jetë e zbatueshme për shkak të kësaj Marrëveshje (i) shuma e Çmimit të Shitjes apo çdo shumë që eventualisht mund të bëhet e pagueshme kundrejt Shitësit sipas kësaj Marrëveshje, do të shtohet me shumën e nevojshme në masën që, pasi bëhen të gjitha zbritjet e detyrueshme, (duke përfshire zbritjet e aplikuara në shumat shtese të pagueshme sipas këtij paragrafi) Shitësi të marrë një shumë të barabartë me atë që do të merrte sikur të mos ishin kryer zbritjet në fjalë (ii) Blerësi duhet t'i beje zbritje të tilla kur janë të detyrueshme nga ligji dhe (iii) Blerësi duhet t'i paguajë të gjithë shumën e

2006

zbritur Autoritetit Publik kompetent sipas ligjit që zbatohet në këtë rast. Blerësi pranon të paguajë të gjitha taksat e pullës, dokumenteve, ose regjistrimit, sot ose në të ardhmen, që rrjedhin nga çdo pagesë për hartimin, dërgimin ose regjistrimin në lidhje me këtë Marrëveshje.

2.3 Shitësi zhvishet nga çdo e drejtë pronësie, dividendi dhe nga të drejtat në administrimin e Shoqërisë, si dhe nga çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga mbajtja e pjesëve të kapitalit në Shoqëri dhe Blerësi bëhet i vetmi pronar i ligjshëm mbi pjesët e kapitalit objekt i kësaj Marrëveshjeje, pasi Blerësi të ketë paguar të gjithë Çmimin e Shitjes të sipërpërmëndur.

NENI 3

DEKLARIME DHE GARANCI

3.1 Shitësi deklaron dhe garanton se: (i) është një person Juridik, i krijuar dhe rregjistruar sipas ligjit të shtetit shqiptar (ii) Shitësi ka nënshkruar plotësisht dhe shlyer të gjitha Kuota (Pjesët) e Shitësit, (iii) kjo marrëveshje përbën detyrim ligjor, të vlefshëm, të detyrueshëm dhe të pashmangshëm për Shitësin.

3.2 Blerësi deklaron dhe garanton se: (i) merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje: (ii) merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga qenia anëtar i kësaj Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. (ii) Blerësi është në dijeni të plotë mbi gjëndjen ekonomike dhe financiare të Shoqërisë dhe i pranon Kuotat (Pjesët) e Shitësit ashtu siç janë dhe pa asnjë pretendim tjetër në lidhje me to (iii) nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nga ana Blerësit është autorizuar në mënyrë të rregullt prej tij dhe ortakëve të Blerësit dhe nuk vjen në kundërshtim me ligjin, (iv) kjo Marrëveshjeje është nënshkruar rregullisht dhe përbën një detyrim të ligjshëm dhe të ekzekutueshëm ndaj Blerësit në përputhje me kushtet e parashikuara në to.

NENI 4

TË NDRYSHME

4.1 Secila prej palëve do të përballojë shpenzimet e veta në lidhje me negocimin dhe ekzekutimin e transaksioneve të parashikuara në këtë Marrëveshjeje dhe asnjë shpenzim i Shoqërisë në çfarëdo lloj forme në lidhje me shit-blerjen e realizuar nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje nuk do t'i ngarkohet e as nuk do të paguhet nga Shitësit.



- 4.2 Kjo Marrëveshje përgatitet dhe nënshkruhet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe ky akt përbën të gjithë marrëveshjen e arritur midis palëve, premtimet, deklaratimet, garancitë në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje. Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të përfaqësues të autorizuar rregullisht nga secila palë.

NOTERIA
TIRANË
NENI 5

LIGJI ZBATUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

- 5.1 Për çështjet të cilat nuk janë parashikuar në këtë Marrëveshje apo që mund të rrjedhin prej saj do të zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë i cili është ligji i zbatueshem për këtë Marrëveshjeje.
- 5.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk zgjidhet me mirëkuptim mes vetë palëve, do të zgjidhet nga Gjykata rrethi gjyqësor Tiranë, vendimet e së ciles janë të ankimueshme sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Unë Noteria, e lexoj tekstin e këtij akti me zë të lartë dhe të kuptueshëm palëve, të cilët, pasi më deklaruan se teksti i këtij akti është në përputhje të plotë me thëniet dhe vullnetin e tyre, e nënshkruajnë atë rregullisht në praninë time, dhe unë Noteria vërtetoj sa më sipër sipas ligjit në fuqi.

SHITËSI

1. Arjan Lako *A. Lako*
2. Andrea MALIQARI *M. Malia*
3. Arminitray Arminitray *flu.*

BLERËSI

Arjan Lako
Arjan Lako

Notero
Ilirjano Gelo